

FORTESA BETON SH.P.K.

Rruga, Magj. Prizren-Prishtinë, Korishë



RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR IMPIANTIN E PRODHIMIT TË BETONIT DHE ELEMENTEVE NGA BETONI

INVESTITORI: FORTESA BETON SH.P.K.,

Rruga, Magj. Prizren-Prishtinë, Korishë

Prizren: Maj/2025

Marrëveshje Bashkëpunimi Për:
Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis
Impianti për Prodhimit të Betonit dhe Elementeve nga Betoni

Ndërmjet:

1. Fortesa Beton SH.P.K. me adresë: Rruga, Magj. Prizren-Prishtinë, Korishë me numër Unik Biznesi: 812124121, e përfaqësuar nga Urim Kabashi – pronar

dhe

2. Besim REXHEPAJ, lindur me 17.06.1964 me numër personal: 1030633152 nga Suhareka, person i licencuar për hartimin e Raporteve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis me numër licence: 14/19/24.

Besim Rexhepaj autorizohet për përgatitjen dhe dorëzimin e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Impiantin e Prodhimit të Betonit dhe Elementeve nga Betoni, në përputhje me Ligjin me nr. 08/L- 181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe rregulloret në fuqi, në ngastrat kadastrale me nr: P-71813037-02271-1, P-71813037-02271-7, P-71813037-02270-4, P-71813037-02269-3; Zona kadastrale Korishë, Komuna e Prizrenit.

FORTESA BETON SH.P.K

Urim Kabashi

Nënshkrimi dhe Vula

Besim REXHEPAJ

I Licencuar për VNM, Nr. i Licencës: 14/19/24

Nënshkrimi

Prizren: Maj/2025

CERTIFIKATAT E KOMPANISË INVESTUESE

 Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo Qeveria - Vlada - Government Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade	
 AGENCIA E REGJISTRIMIT TË BIZNESIT NË KOSOVË KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJU BIZNISA KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY	
CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT CERTIFIKAT O REGISTRACIJI CERTIFICATE OF REGISTRATION	
817124121 Numri Unik Identifikues / Jedinstven: Matični Broj / Unique Identification Number	
Fortesa Beton SH.P.K. Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business	
Fortesa Beton Emri tregtar / Trgovničko ime / Commercial name	
Lloji biznesit: Poslovni tip: Business type:	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar Društvo sa ograničenom odgovornošću Limited Liabilities Companies
Adresa: Adresa: Address:	Magj. Prizren-Prishtinë, // Korishë Prizren
Data e regjistrimit: Datum registracije: Date of registration:	02/02/2024
02/02/2024 Data / Date / Datum	
Nr. ser. / Ser. br. / Ser. No.	 Nënshkrimi / Signature / Potpis
10178240	



AGJENSIONI I REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE NË KOSOVË
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

Informata mbi biznesin
Information about business
Informacija o biznisu

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number
812124121

Aplikacioni / Application / Aplikacija

Subjekti i regjistrimit:
Registration subject:
Subjekt registracije:

Data e plotësimit:
Filling date: 30/01/2024
Datum:

Data e pranimit:
Reception date: 30/01/2024
Datum pramljenje:

Numri i protokollit:
Protocol number: 20010101924
Broj protokola:

Biznesi / Business/ Biznis

Tipi i biznesit
Business Type
Tip biznisa
Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara
Limited Liabilities Companies
Društvo sa ograničenom odgovornošću

Emri i biznesit:
Business name:
Naziv biznisa:
Fortesa Beton SH.P.K.

Emri tregtar:
Trgovачko ime:
Commercial name:
Fortesa Beton

Adresa
Address
Adresa
Magj. Prizren-Prishtinë, //
Korishë
Prizren

Data e themelimit:
Date of establishment: 02/02/2024
Datum osnivanja:

Kapitali i përgjithshëm:
Total Capital: € 24,000.00
Totalni kapital:

Numri i punëtorëve:
Number of employees: 5
Broj radnika:

Rr. "Muharrem Fejza" p.n, Lagjja e Spitalit, Prishtinë
Data / Date / Datum: 02/02/2024 09:10

Tel1: 038 200 36 562
Tel2: 038 200 36 573

Faqe 1 nga 5



AGJENSIONI I REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE NË KOSOVË
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

Informata mbi biznesin
Information about business
Informacija o biznisu

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number
812124121

Shënim me rëndësi / Important Note / Vazan podatak

Informata plotësuese / Additional Information Note / Dodatna informacija

Rr. "Muharrem Fejza" p.n, Lagjja e Spitalit, Prishtinë
Data / Date / Datum: 02/02/2024 09:10

Tel1: 038 200 36 562
Tel2: 038 200 36 573

Faqe 2 nga 5



AGJENSIONI I REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE NË KOSOVË
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

Informata mbi biznesin
Information about business
Informacija o biznisu

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number
812124121

Veprimtaritë / Activities / Delatnosti		
2363	Aktiviteti kryesor i biznesit	Prodhimi i betonit të përzier, i gatshëm për përdorim Manufacture of ready-mixed concrete Proizvodnja žbuke
2361	Aktiviteti sekondar	Prodhimi i produkteve prej betonit për qëllime ndërtimi Manufacture of concrete products for construction purposes Proizvodnja proizvoda od betona za građevinarstvo
2362	Aktivitetet tjera	Prodhimi i produkteve prej llaçit për qëllime ndërtimi Manufacture of plaster products for construction purposes Proizvodnja proizvoda od gipsa za građevinarstvo
2364	Aktivitetet tjera	Prodhimi i llaçeve Manufacture of mortars Proizvodnja gotove betonske smese
2365	Aktivitetet tjera	Prodhimi i fibrave të çimentos Manufacture of fibre cement Proizvodnja fibro-cementa
2369	Aktivitetet tjera	Prodhimi i artikujve të tjerë prej betonit, llaçit dhe çimentos Manufacture of other articles of concrete, plaster and cement Proizvodnja ostalih proizvoda od betona, cementa i gipsa
4941	Aktivitetet tjera	Transporti rrugor i mallrave Freight transport by road Drumski prevoz robe

Filialet / Branches / Jedince

Bordi drejtorëve / Board of Directors / Upravni odbor

Rr. "Muharrem Fejza" p.n, Lagjia e Spitalit, Prishtinë
Data / Date / Datum: 02/02/2024 09:10

Tel1: 038 200 36 562
Tel2: 038 200 36 573

Faqe 3 nga 5



AGJENSIONI I REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE NË KOSOVË
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

Informata mbi biznesin
Information about business
Informacija o biznisu

Pronarët / Owners / Vlasnici

Person fizik

Emri: Name: Ime:	Urim Kabashi
ID Personale: Personal ID: Licni ID:	1007531369
Adresa: Address: Adresa:	Korishë Korishë Prizren, Kosova
Përgjegjësia: Liability: Odgovornost:	
Pjesa në pronë: Owned part: Deo o vlasnistvu:	8,000.00€
Data: Date: Datum:	14/02/1981



Aksionar / Shareholder / Akcionarsko



Aksionar i privilegjuar / Privileged shareholder/ Privilegovani akcionar

Person fizik

Emri: Name: Ime:	Fitim Kabashi
ID Personale: Personal ID: Licni ID:	1007531377
Adresa: Address: Adresa:	Korishë Korishë Prizren, Kosova
Përgjegjësia: Liability: Odgovornost:	
Pjesa në pronë: Owned part: Deo o vlasnistvu:	8,000.00€
Data: Date: Datum:	15/11/1982



Aksionar / Shareholder / Akcionarsko



Aksionar i privilegjuar / Privileged shareholder/ Privilegovani akcionar

Rr. "Muharrem Fejza" p.n, Lagjja e Spitalit, Prishtinë
Data / Date / Datum: 02/02/2024 09:10

Tel1: 038 200 36 562
Tel2: 038 200 36 573

Faqe 4 nga 5



AGJENSIONI I REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE NË KOSOVË
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

Informata mbi biznesin
Information about business
Informacija o biznisu

Person fizik

Emri: Name: Ime:	Genc Kabashi
ID Personale: Personal ID: Licni ID:	1173291392
Adresa: Address: Adresa:	Korishë Korishë Prizren, Kosova
Përgjegjësia: Liability: Odgovornost:	
Pjesa në pronë: Owned part: Deo o vlasnistvu:	8,000.00€
Data: Date: Datum:	28/03/1989



Akcionar / Shareholder / Akcionarsko



Akcionar i privilegjuar / Privileged shareholder/ Privilegovani akcionar

Personat e autorizuar / Authorized participants / Ovlašćene lice

Emri: Name: Ime:	Urim Kabashi
ID Personale: Personal ID: Licni ID:	1007531369
Pozita e punës: Job position: Radno mesto:	Drejtore menaxhues
Adresa: Address: Adresa:	Korishë Korishë Prizren, Kosova
Autorizimet: Authorizations: Autorizacije:	Person i autorizuar

Rr. "Muharrem Fejza" p.n, Lagjja e Spitalit, Prishtinë
Data / Date / Datum: 02/02/2024 09:10

Tel1: 038 200 36 562
Tel2: 038 200 36 573

Faqe 5 nga 5

LICENCA E HARTUESIT TË RAPORTIT



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
 Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
 Ministarstvo Zivotne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
 Ministry of Environment Spatial Planing and Infrastructure

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.08L/181 dhe Udhëzimi Administrativ për
 Licencim të Hartuesëve të Raporteve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.10/2017, Ministri i MMPHI
 lëshon:

Nr. i licencës: 14/19/24

LICENCË

Besim REXHEPAJ

Ms.i Gjeologjisë

Licencohet si person fizik për hartimin e raporteve të VNM-së

Data e vlefshmërisë:
 12.08.2024— 11.08.2029
 Prishtinë

Z. Liburn Aliu
 Ministër i MMPHI

Përmbajtja

1.	HYRJE	15
2.	KUADRI LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT	16
3.	METODOLOGJIA E PUNËS	17
4.	PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT	17
4.1	Pozita gjeografike e lokacionit	17
4.2	Popullata dhe vendbanimet	19
4.3	Lidhjet e komunikacionit dhe Distanca nga Shtëpitë	21
4.4	Kushtet klimatike Temperaturat mesatare mujore dhe vjetore	22
4.5	Karakteristikat hidrologjike	25
4.6	Natyra dhe biodiversiteti	26
4.7	Flora	26
4.8	Fauna	27
4.9	Peizazhi	28
4.10	Ajri	28
5.	PROCESIT TEKNOLOGJIK I PRODHIMIT TË BETONIT DHE ELEMENTEVE NGA BETONI SI DHE PAJIMET	29
a.	Objektet – pajimet e bazës së betonit	29
b.	Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit	31
c.	Koncepti prodhues i betonit	32
d.	Prodhimi i betonit	32
e.	Komponentët e betonit	33
f.	Përshkrimi i procesit teknologjik i prodhimit të betonit	35
g.	Përshkrimi i procesit teknologjik i prodhimit të elementeve nga betonit	36
6.	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË ARSYESHME	38
a.	Zonat me industri të njëjta ekzistuese:	39
b.	Sipërfaqet e fushave të gjelbërta:	39
c.	Afërsia me lëndët e para:	39
d.	Infrastruktura e transportit:	39
e.	Ndikim mjedisor:	39
f.	Zonimi dhe rregulloret:	39
g.	Marrëdhëniet me komunitetin:	39
h.	Shërbimet komunale dhe infrastruktura:	40
i.	Kushtet gjeologjike dhe gjeoteknike:	40
j.	Kërkesa e tregut:	40

6.1	Mbrojtje dhe siguri:	40
6.2	Potenciali i zgjerimit:	40
6.3	Logjistika dhe vendi i lokacionit:.....	40
6.4	Qëndrueshmëria mjedisore:.....	40
6.5	Afërsia me fuqinë punëtore:.....	41
7.	IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	41
a.	Ndikimet në ajër.....	41
b.	Ndikimet në tokë.....	42
c.	Ndikimet në ujë.....	42
d.	Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë	43
e.	Ndikimi në vendbanime dhe popullatë.....	43
f.	Ndikimi nga zhurma	43
g.	Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore	44
8.	MASAT PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE NË MJEDIS.....	44
a.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër	44
b.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	44
c.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë	45
d.	Masat për mbrojtjen nga Zhurma	46
e.	Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet.....	47
9.	PROGRAMI I MONITORIMIT	47
10.	RAPORTIMI.....	47
11.	MASAT REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETIT	48
12.	KONKLuzion	48
13.	ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT NË FORMË TABELARE.....	49
14.	LITERATURA E PERDORUR.....	50

Lista e Figurave:

Figura 1. Pozita Gjeografike e Komunës së Prizrenit në Hartën e Republikës së Kosovës	18
Figura 2. Harta e rrugëve dhe Lokacioni i Kompanisë nga Komuna e Prizrenit	19
Figura 3. Lokacioni i Kompanisë nga fshatrat përreth parcelave	20
Figura 4. Distanca e lokacionit të kompanisë nga shtëpitë e banimit	21
Figura 5. Prizren – trëndafili i erës 2020	23
Figura 6. Hidrografia në komunën e Prizrenit	25
Figura 7. Impianti i prodhimit të betonit dhe elementeve nga betoni FORTESA BETON SH.P.K.	30
Figura 8. Vendosija e fraksioneve të zhavorrit në afërsi të Impiantit të prodhimit të Betonit	32
Figura 9. Figura 11 Skema e procesit teknologjik	38

Lista Tabelave:

Tabela 1. Temperaturat mesatare mujore	22
Tabela 2. Prizren - të dhënat klimatologjike 2020 në zonën e interesit	24
Tabela 3. Tabela 2 Bilanci për prodhimin e 1 m ³ beton MB-30	34
Tabela 4. Tabela 4 Bilanci për prodhimin e 1 m ³ beton	35
Tabela 5. Tabela e kost-benefiteve të investimit	49

1. HYRJE

Ky Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis është punuar për Impiantin e prodhimit të betonit dhe elementeve nga betoni, me investitor FORTESA BETON SH.P.K. në ngastrat kadastrale me nr. P-71813037-02271-1, P-71813037-02271-7, P-71813037-02270-4, P-71813037-02269-3; Zona kadastrale Korishë, Komuna e Prizrenit, i cili është përgatitur duke u bazuar në legjislacionin mjedisor të Kosovës, veçanërisht sipas Ligjit nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Prodhimi i betonit elementeve nga betoni është një pjesë e rëndësishme e sektorit të ndërtimtarisë në Kosovë dhe është zhvilluar paralelisht me kërkesat e këtij sektori. Për shkak të specifikave të tij që lidhen kryesisht me mënyrën e transportimit të produktit final (betonit) - betoni i gatshëm nuk mund të transportohet në distanca shumë të mëdha dhe për këtë arsye është imponuar ndërtimi i impianteve të tilla në tërë territorin e Kosovës me lokacione të ndryshme.

Edhe pse si aktivitet, prodhimi i betonit elementeve nga betoni nuk përfshinë djegie të lëndëve fosile, ndërhyrje fizike të theksuara në mjedis apo shfrytëzim të resurseve ujore, megjithatë, si aktivitet është i pakontrolluar dhe herë pas herë mund të ketë ndikime në mjedis, prandaj edhe është subjekt i procedurave për Pëlqim Mjedisor.

Kompania FORTESA BETON SH.P.K. ka iniciuar hartimin e raportit të VNM-së për të identifikuar ndikimet e mundshme në mjedis, me qëllim të ndërmarrjes së masave të nevojshme dhe zgjedhjen e alternativave për minimizimin e ndikimeve negative në mjedis.

Të dhënat për hartimin e raportit janë siguruar nga burime të ndryshme, literaturë ekzistuese, Plani zhvillimor komunal i Prizrenit, raportet e ndryshme mbi vlerësimin e aktiviteteve të ngjashme, dhe gjithashtu janë realizuar vizita në vendin ku është bërë ngritja e Impiantit për prodhimin e Betonit dhe elementeve të tij me qëllim të njohjes me zonën, me pajimet, objektin, procesin teknologjik dhe infrastrukturën në lokacion.

Duke e pasur parasysh se sektori i ndërtimeve në Kosovë, përfshirë ndërtimin e rrugëve për qarkullimin e automjeteve është një nga sektorët me zhvillimin më të madh, si dhe duke e pasur parasysh kërkesën për materiale ndërtimore kompania FORTESA BETON SH.P.K., ka ngritur impiantin për prodhimin e betonit.

Lokacioni i impiantit për prodhimin e betonit elementeve nga betoni është i vendosur në njësinë e kadastrave me nr. P-71813037-02271-1, P-71813037-02271-7, P-71813037-02270-4, P-71813037-02269-3; Zona kadastrale Korishë, Komuna e Prizrenit. Impianti ka kapacitet prej 60 m³/h. Lënda e parë, kryesisht gurë gëlqeror, sigurohet nga operatorët e licencuar, ndërsa çimento sigurohet në tregun e Kosovës, kryesisht nga prodhuesi vendor “Sharr Cem” dhe prodhuesi nga Shqipëria “Kruja Cem”. Kompania do të prodhojë beton të markave të ndryshme dhe elemente nga betoni, varësisht prej kërkesave të klientëve, dhe produktet e tij do të shet kryesisht në zonën e Prizrenit dhe Suharekës.

2. KUADRI LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT

Duke marr në konsideratë karakteristikat e projektit, madhësinë e shtrirjes së tij, ndikimet e mundshme në mjedis si dhe vendndodhjen e impiantit si dhe duke u bazuar në legjislacionin mjedisor në fuqi ku parashihet që ky projekt është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe i përket shtojcës së dytë, nënpika 5.8, e Ligjit nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar ligje të tjera relevante, si Ligjet:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për Mbrojtje nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për Ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për mbrojtje nga Zjarri me nr, 04/L-012

Udhëzimet Administrative:

- Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr. 02/2022 për Kushtet, Mënyrat, Parametrat dhe Vlerat Kufizuese të Shkarkimit të Ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në Trupin Ujorë.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave,
- Udhëzim Administrativ (QRK) nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes.

3. METODOLOGJIA E PUNËS

Për të vlerësuar ndikimin në mjedis si dhe për të identifikuar masat para parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, për impiantin për prodhimin e betonit dhe elementeve nga betoni, është ndjekur qasja e vlerësimit të përgjithshëm të projekteve të kësaj natyre, si dhe është bërë analiza dhe identifikimi i ndikimeve sipas fazave.

a. Informatat themelore mbi:

- Burimet themelore të ndikimeve në mjedis
- Popullatën dhe vendbanimet në lokacion
- Topografia dhe peizazhi në lokacionin e projektit
- Klima dhe të dhënat meteorologjike
- Kualiteti i ajrit ujit dhe komponentëve tjerë mjedisor në lokacion
- Bota bimore dhe shtazore në lokacionin e projektit

b. Vlerësimi i ndikimeve sipas kritereve në vijim:

- Gjendja e mjedisit në lokacionin e projektit
- Lloji dhe madhësia e pritshme e ndotjes nga projekti
- Karakteristikat dhe përbërja e materialit ndotës
- Vlerësimi i përhapjes së ndotjes

c. Përcaktimi i masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, duke u bazuar në rezultatet / të gjeturat nga vlerësimi i ndikimeve në mjedis, në lokacionin e projektit.

4. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT

4.1 Pozita gjeografike e lokacionit

Komuna e Prizrenit kufizohet me Komunat e Gjakovës, Rahovecit, Suharekës, Mamushës, Shtërpçës dhe Dragashit si dhe me Shqipërinë dhe Maqedoninë.

Territori i Prizrenit mbulohet me një pjesë të maleve në vijim: Sharr, Oshlak, Koritinik, Pashtrik dhe pjesërisht përbëhet nga fusha të rrafshëta të luginës së Dukagjinit. Pjesët malore me lartësi mbidetare mbi 1500 m përfshijnë afro 15% të gjithë kufijve komunal. Maja më e lartë në Komunën e Prizrenit ndodhet në Malet e Sharrit në anën lindore dhe juglindore me një lartësi mbidetare prej 2600m. Malet e Sharrit kufizohen me Maqedoninë në juglindje, me Komunën e Dragashit në Jug, me Komunën Shtërpçës në lindje dhe me Komunën e Suharekës në verilindje. Lugina e Zhupës, baza e lumit Lumëbardhi, shtrihet përgjatë këtyre maleve drejt Prizrenit. Malet e Pashtrikut në kufirin Shqiptar në perëndim janë malet e dyta me lartësi mbidetare me 1950 m.

Prizreni në përgjithësi ka një topografi të valëzuar ku lartësia mbidetare sillet prej 300 m - 2600 m. Përderisa qyteti i Prizrenit ndodhet në sipërfaqen e rrafshët, topografia kodrinore vërehet në pjesën perëndimore dhe lindore të komunës. Lartësia mbidetare e qendrës së qytetit është 400 m. Koordinatat e Prizrenit janë 42° 00 dhe 42° 20 veri dhe 20° 30 dhe 21° Lindje. Pozita gjeografike e Prizrenit ofron kushte të volitshme për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, industrinë e ushqimit dhe turizmin.



Figura 1. Pozita Gjeografike e Komunës së Prizrenit në Hartën e Republikës së Kosovës

Komuna e Prizrenit është njësi administrative në pjesën jugore të Kosovës, me një sipërfaqe prej 640 km² (5.94% të territorit të Kosovës) gjendet në jug-perëndim të Kosovës dhe me 76 vendbanime dhe me 178.112 banorë nga të cilët në Prizren janë rreth 120.000 banorë.

Ndërsa kompania FORTESA BETON SH.P.K. me lokacion në fshatin Korishë K. E Prizrenit, pranë rrugës magjistrale M-25 Suharekë – Prizren.




Figura 2. Harta e rrugëve dhe Lokacioni i Kompanisë nga Komuna e Prizrenit

Më saktësisht lokacioni gjendet në njësinë kadastrale me nr. P-71813037-02271-1, P-71813037-02271-7, P-71813037-02270-4, P-71813037-02269-3; Zona kadastrale Korishë, Komuna e Prizrenit, me sipërfaqe 8070.90 m², është e vendosur Impianti për prodhim Betoni dhe Elementeve nga Betoni.

Impianti gjendet rreth 5.0 km në veri të K. Prizren. Lokacioni i Impiantit është me pjerrësi te but dhe ka një lartësi mbidetare 405m, ndërkohë që e gjithë topografia e zonës karakterizohet nga terren i rrafshët. Zona karakterizohet me toka bujqësore dhe vendbanime të shpërndara.

Lokacioni ashtu si pjesa veriore e territorit të Prizrenit që është i rrafshët edhe territori ku gjendet impianti për beton është i rrafshët me pjerrësi te but.

Nëpër territorin e kësaj zone, me një pozitë të mirë gjeografike, kalojnë rrugë shumë të rëndësishme që e lidhin kryeqendrën, Prishtinën, me qendrën regjionale Prizrenin dhe kalojnë më tej në Shqipëri. Si e tillë ajo ka një pozitë të rëndësishme strategjike në këtë pjesë të Kosovës.

4.2 Popullata dhe vendbanimet

Popullata, zhvillimet demografike, si dhe vendbanimet, paraqesin disa nga veçoritë kryesore të cilat duhet të konsiderohen në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis. Kjo për shkak se afërsia e vendbanimeve, dhe popullatës, ndaj aktiviteteve janë ndër faktorët kryesor, të cilët i ekspozohen ndikimeve në mjedis.

Komuna e Prizrenit ka një sipërfaqe prej 627 km² (5.94 % të territorit të Kosovës), e cila gjendet në jugperëndim të Kosovës me 76 vendbanime me 177781 banorë, me popullsi urbane 94.517 banorë dhe popullsi rurale me 83.264 banorë.

Sipas të dhënave preliminare të vitit 2024, Komuna e Prizrenit ka mbi 147 mijë banorë, teksa në vitin 2011 kishte 178 mijë banorë.

Fshatrat e komunës së Prizrenit: Arbana (Dushanova), Arbëri (Leskoveci), Arbënori (Serbica e Epërme), Arbneshi (Serbica e Poshtme), Atmaxha, Caparci, Dedaj, Dojnica, Drajçiqi, Drinasi (Vërrmica), Flokati (Lutogllava), Gërçari, Gornjasella, Grazhdaniku, Gurishta (Gorozhupi), Gurra (Poslisht), Gjeçi (Jeshkova), Gjonaj, Hoça e Qytetit, Ilirasi (Medveci), Jabllanica, Kabashi, Kabashi i Hasit, Kobaja, Kojusha, Krisha, Krajku, Krusha e Vogël, Kushtendili, Kushnini, Kushtrimi (Bilusha), Lezi, Landovica, Livadhia (Petrovosella), Lubinja e Epërme, Lubinja e Poshtme, Lubishta, Lugishta, Lukinaj, Llokvetica, Mamusha, Manastiri, Mazreku, Mirëza (Dobrushta), Mirditi (Trepetnica), Milaj, Murademi, Mushnikova, Nasheci, Novosella, Pirana, Planeja, Pllanjani, Pouska, Prizreni, Pusi i Atit (Nova Shumadija), Qëndresa (Randobrava), Reçani, Romaja, Skorobishti, Smaçi, Srecka, Shëngjergji (Karashëngjergji), Shkoza, Shpinadia, Shtrunga (Shtruzha), Tupeci, Velezha, Vërrinasi (Lybiqueva), Zhiviniani, Zojzi, Zymi, Zhuri.

Prizreni është një nga pesë komunat më të dendura të Kosovës me 375 persona për km² në vitin 2009. Gjatë studimit hulumtues nga tereni të PZHK që u zhvillua në vendbanimet rurale të komunës së Prizrenit duke i anketuar 75 kryetar të fshatrave, popullsia e gjithmbarshme është llogaritur me numrin e banorëve të cilët jetojnë në komunën e Prizrenit, duke ia shtuar numrin e personave që jetojnë në botën e jashtme. Qyteti i Prizrenit nuk ishte i përfshirë në

Ndërsa impianti i betonit dhe elementeve nga betoni ndodhet në hyrje të fshatit Korishë.




Figura 3. Lokacioni i Kompanisë nga fshatrat përreth parcelave

Është me rëndësi të thuhet se projekti nuk parasheh zhvendosjen e ndonjë shtëpie banimi, dhe ndikimet e drejtpërdrejta në popullatë dhe vendbanim janë të përkohshme. Impianti për prodhimin e betonit elementeve nga betoni në pikëpamje mjedisore nuk pritet të ketë ndonjë ndikim të theksuar në popullatë (zhvendosje), ndërsa në anën tjetër, pritet të ketë efekte pozitive, në punësimin e tyre.

Ne afërsi të impianti janë një numër mjaftë i vogël i shtëpive, shih fig. 4 e më poshtme. Pronari i kompanisë FORTESA BETON SH.P.K. është zotuar që do të përmbahet të gjitha ligjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ambientit dhe do të jetë i kujdesshëm gjatë operimit që mos të i shqetësojë banoret në këtë lokalitet.

4.3 Lidhjet e komunikacionit dhe Distanca nga Shtëpitë

Lokacioni ka lidhje të mira komunikacioni si dhe infrastrukturë rrugore e cila e lehtëson transportin, si të lëndës së parë, po ashtu edhe të produkteve finale (betonit të gatshëm dhe elementeve nga betoni). Lokacioni gjendet pranë rrugës regjionale që lidh qytetet si; Suharekën, Malishevën si dhe gjendet në afërsi të kyçjes në Autostradën Ibrahim Rugova. Impianti i prodhimit të betonit elementeve nga betoni ka një distancë prej 152 nga shtëpia më e afërt në vijë ajrore.




Figura 4. Distanca e lokacionit të kompanisë nga shtëpitë e banimit

4.4 Kushtet klimatike Temperaturat mesatare mujore dhe vjetore

Klima e Prizrenit ka karakter kontinental me një ndikim të lehtë të klimës mesdhetare në lartësi më të ulta, ndërsa në male dominon klima e ashpër alpine. (Tabela 1.3). Klima mesdhetare vjen nga deti Adriatik nëpërmes të kanionit të Drinit të Bardhë. Karakteristikat e buta klimatike janë arsye e resurseve të pasura natyrore. Ajo ndihmon në kultivimin e rrushit dhe frutave e perimeve tjera. Distanca nga deti prej 105 km është një tregues i rëndësishëm për kushtet klimatike. Temperatura mesatare më e lartë gjat verës është 22.7 °C. Në verë, kushtet klimatike janë mjaft konsistente dhe precipitimi ndodh herë pas herë ndërsa në dimër kemi të reshura ekstensive. Në vjeshtë vërehen temperaturat më të larta se në pranverë. Mesatarja në vjeshtë është 17.6°C. Në 60% të vitit, temperatura është më e lartë se 0°C pra nuk ka ngrica gjatë 229 ditëve.

Tabela 1. Temperaturat mesatare mujore

Viti	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Temperatura mesatare vjetore
1983	4.3	1.1	7.8	15.3	18.3	18.8	22.1	21.5	17	11.3	3.5	1.5	11.8750
1984	2.8	1.8	5.6	9.9	17.2	19.4	21.7	19.8	18.1	13.6	7.3	1.2	11.5333
1985	-3.9	-4.3	6	13.5	18.5	19.9	22	23	18.1	11.6	7.4	3.9	11.3083
1986	1.7	1.1	6.7	13.4	17.8	19.4	20.6	23	19.1	13	3.7	-0.8	11.5583
1987	1.3	0.8	2.7	11.8	15.9	20.9	25	21	22.5	12.5	7.1	2.5	12.0000
1988	3.1	4.2	6.2	11	17.9	20.4	25.8	24.4	19	11.8	0.5	-0.8	11.9583
1989	-2.2	4.1	10.1	14.3	15.2	18	21.3	22.4	17.8	11.3	4.7	1.2	11.5167
1990	-0.7	5.6	10.5	11.3	16.8	21.6	23.3	22.6	17	13.6	10	0.2	12.6500
1991	-1.1	-0.3	9.7	10	13.4	21.6	22.3	21.7	19.3	12.7	8.4	-1.8	11.3250
1992	0.6	3	7.6	12	16.6	20.1	22.1	25.5	19.3	14.8	8.3	1	12.5750
1993	0.5	0.1	5.5	12.3	17.8	21.3	22.7	24.4	18.4	14.9	4.5	6.1	12.3750
1994	3.7	3.3	10.5	11.9	18.3	21.2	22.3	24.4	21.9	12.8	7.3	2	13.3000
1995	0.7	6.8	6.5	11	15.9	21.2	23.7	20.4	16.5	11.8	4	4.9	11.9500
1996	1.4	1.3	3	11.6	18	22.5	23.2	22.5	15.2	11.9	9.7	3.1	11.9500
1997	2.2	4.9	6.7	7.3	17.5	0	22.7	23	20.8	10	7.3	3.7	10.5083
Temperatura mesatare mujore	0.9	2.2	7.0	11.77	17.0	19.0	22.7	22.6	18.6	12.5	6.2	1.8	11.892

Lagështia e ajrit

Lagështia e ajrit është shumë e rëndësishme për turizmin, shëndetin dhe potencialet bujqësore. Për njeriun lagështia e pranueshme është 40%-70%, ndërsa lagështia mesatare e ajrit në Prizren është 70.4%. Vlerat më të larta të lagështisë vërehen në vjeshtë dhe dimër (75.1%) për shkak të rrymimit të ajrit nga deti Adriatik në dimër. Në verë lagështia është dukshëm më e ultë se 70 % (Tabela 1.4).

Precipitimi është po ashtu një nga komponentët e rëndësishme të strukturës klimatike dhe është esenciale për prodhimtarinë bujqësore të dihen periudhat e precipitimit. Në Prizren të reshurat janë më të larta në dimër.

Erërat

Element me rëndësi i klimës është edhe era. Nga drejtimi i fryerjes, dendurisë dhe fuqisë në shkallë të madhe varen dhe elementet e tjera të klimës.

Denduria e erërave është e shprehur në promil (%). Në tabelën e poshtme janë të shprehura vlerat e dendurisë (frekuencës) së erërave në 16 drejtimet si dhe qetësia e shprehur në promil. m/sec^{-1} .

Trëndafili i erës: 2020
Gjatësia gjeografike e st.: $20^{\circ} 44' 08.41''$

Lartësia mbidetare e st.: 402 m lmd
Gjerësia gjeografike e st.: $42^{\circ} 14' 51.04''$




Figura 5. Prizren – trëndafili i erës 2020

Tabela 2. Prizren - të dhënat klimatologjike 2020 në zonën e interesit

Të dhënat klimatologjike (m/s): 2020

Lartësia mbidetare e st.: 402 m lmd

Gjatësia gjeografike e st.: 20° 44' 08.41"

Gjerësia gjeografike e st.: 42° 14' 51.04

Muaji	Temperaturat (°C)				Temperatura extreme (°C)						Shtypja e ajrit (hPa)	
	7	14	21	Tmes	Tmin	Tmax	Min	Dita	Max	Dita	Mes	
I	-1.9	5.2	0.7	1.0	-	-	-	-	-	-	979.8	
II	3.0	10.8	5.2	6.4	-	-	-	-	-	-	971.8	
III	5.9	12.5	6.9	8.0	-	-	-	-	-	-	968.8	
IV	9.6	17.2	10.7	11.7	-	-	-	-	-	-	969.4	
V	15.2	21.0	14.7	16.1	-	-	-	-	-	-	968.4	
VI	19.2	24.9	18.7	20.0	-	-	-	-	-	-	961.8	
VII	21.8	29.8	21.2	23.1	-	-	-	-	-	-	966.1	
VIII	20.2	29.3	21.1	22.6	-	-	-	-	-	-	964.8	
IX	16.8	26.3	18.7	19.9	-	-	-	-	-	-	967.8	
X	9.5	18.7	11.7	12.8	-	-	-	-	-	-	965.5	
XI	3.0	10.7	4.4	5.7	-	-	-	-	-	-	974.0	
XII	2.4	6.0	3.0	3.7	-	-	-	-	-	-	965.5	
Viti	10.4	17.7	11.4	12.6	-	-	-	-	-	-	968.6	

Muaji	Lagështia e ajrit (%)				RD (h)	Mbulueshmëria me re (0-10)				Reshje shiu (mm)			Bora (cm)	
	7	14	21	Mes	Σ	7	14	21	Mes	Σ	Max	Dita	Tot	Ere
I	91	63	83	80	-	-	-	-	-	14.4	7.7	29/01	-	-
II	78	51	72	66	-	-	-	-	-	64.1	22.0	04/02	-	-
III	76	51	71	67	-	-	-	-	-	41.6	10.7	07/03	-	-
IV	66	44	61	58	-	-	-	-	-	42.5	11.1	21/04	-	-
V	73	50	71	66	-	-	-	-	-	58.5	33.3	20/05	-	-
VI	69	50	70	66	-	-	-	-	-	39.4	14.0	23/06	-	-
VII	65	38	66	60	-	-	-	-	-	13.0	6.5	03/07	-	-
VIII	79	46	74	69	-	-	-	-	-	46.9	14.8	06/08	-	-
IX	77	43	67	65	-	-	-	-	-	53.3	30.3	23/09	-	-
X	93	58	86	81	-	-	-	-	-	81.3	25.7	15/10	-	-
XI	96	68	93	88	-	-	-	-	-	4.3	2.2	30/11	-	-
XII	94	84	93	91	-	-	-	-	-	34.0	6.9	27/12	-	-
Viti	80	54	76	71	-	-	-	-	-	493.3	33.3	20/05	-	-

Muaji	Ditë me												
	Temperaturat (°C)						Shpejtësia e erës (m/s)		Mbulueshmëria me re (0-10)		Reshje shiu (mm)		
	Tn ≤ -10	Tn < 0	Tn ≥ 20	Tx < 0	Tx ≥ 25	Tx ≥ 30	> 6	> 8	< 2	> 8	≥ 0.1	≥ 1	≥ 10
I	-	-	-	-	-	-	11	4	-	-	6	3	0
II	-	-	-	-	-	-	15	11	-	-	10	8	2
III	-	-	-	-	-	-	9	3	-	-	9	7	1
IV	-	-	-	-	-	-	12	5	-	-	12	6	2
V	-	-	-	-	-	-	13	8	-	-	8	4	2
VI	-	-	-	-	-	-	14	3	-	-	11	5	2
VII	-	-	-	-	-	-	10	3	-	-	4	4	0
VIII	-	-	-	-	-	-	4	0	-	-	8	6	2
IX	-	-	-	-	-	-	6	1	-	-	7	5	2
X	-	-	-	-	-	-	3	0	-	-	9	7	4
XI	-	-	-	-	-	-	3	2	-	-	3	2	0
XII	-	-	-	-	-	-	7	4	-	-	11	9	0
Viti	-	-	-	-	-	-	107	44	-	-	98	66	17

4.5 Karakteristikat hidrologjike

Komuna e Prizrenit ka rrjet mjaft të zhvilluar hidrografike, gjegjësisht ka numër mjaft të madh të lumenjve (përroskave) që kalojnë në territorin e komunës. Lumenjtë e vegjël janë lumenj me tipare karakteristike për përroskat malore, që dmth lumenj të vegjël, me oscilime shumë të mëdha të sasisë së ujit gjatë vitit.

Gjatë kohës së thatë në shumicën e këtyre lumenjve ka shumë pak ujë ose nuk ka ujë fare, kurse gjatë kohës me reshje shpesh ndodh që të ketë vërshime lokale.

Lumi më i madh i komunës dhe arteria kryesore hidrografike është Lumi Lumbardhi. Ky lum formohet nga përroskat lokale. Lumbardhi i Prizrenit është 35.5 kilometra i gjatë dhe ka një sipërfaqe të pellgut prej 279 km². Mbi gjysma e sipërfaqes së pellgut janë toka punuese, rreth 30% livadhe dhe kullosa, 10% male dhe pjesa tjerë është djerrinë.

Lumi i Korishës: - ka karakter vërshues me një sipërfaqe të pellgut prej 24,25 km² dhe një gjatësi të rrjedhës ujore 8.5km. kalon nëpër fshatin Korishë, ka krijuar një shtrat të thellë dhe dhe buzë lokacionit të impjantit për prodhimin e betonit dhe elementeve nga betoni. Vërshimi i lumit fillon nga fshati Korishë dhe vazhdon gjer tek magjistralia Prizren – Suharekë. Ky lum sjell sasi të mëdha të materialit të bartur në Lumin Toplluhë dhe përmes këtij lumi në Lumin Drin.

Ndërsa sa i përket lokacionit ku është duke operuar impianti për prodhimin e betonit dhe elementeve nga betoni, nuk ka ndotje të ujerave sepse pse nga procesi teknologjik i prodhimit të betonit dhe elementeve nga betoni nuk ka shkarkime të ujerave të ndotur në lum.




Figura 6. Hidrografia në komunën e Prizrenit

4.6 Natyra dhe biodiversiteti

Aktivitetet primare ekonomike ku përfshihet bujqësia me degët e saja, janë veprimtari ekonomike që historikisht kanë dominuar në këtë komunë. Llojllojshmëria e monumenteve natyrore të karakterit botanik në Komunën e Prizrenit dhe peizazhet e shumëllojshme natyrore që janë të shpërndara në komunë konsiderohen si vlera natyrore të trashëgimisë. Zona totale e pyjeve si habitatet më të pasura është rreth 23,570 ha, ku sektori privat i ka rreth 3,897 ha dhe 12,170 ha janë pronë publike.

Bazuar nga të dhënat e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AKMM) respektivisht sipas Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN), PZHK- Prizren 2013-25, por edhe sipas observimeve në terren, në afërsi të lokacionit ku gjenden impiantet e cekura, nuk ka zona të mbrojtura. (AMMK-IKMN 2008, 2010).

Sipas Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, por edhe sipas observimeve në terren, në lokacionin e projektit nuk ka zonë të mbrojtur, nuk ka lloje të mbrojtura, të rralla, apo endemike, dhe po ashtu nuk ka një potencial për vënie nën mbrojtje të zonës apo të ndonjë lloji, andaj ky impiant për prodhimin e betonit dhe elementeve nga betoni nuk do të sjell ndonjë problem në lokacionin ku është i vendosur.

4.7 Flora

Sipërfaqet bujqësore, si sipërfaqet të rëndësishme ekonomike paraqesin bazën të rëndësishme natyrore për Komunën e Prizrenit. Kushtet të volitshme klimatike, sidomos numri i madh i ditëve me diell gjatë sezonit veror si dhe ujitja me anë të pipave kanë dhënë efekte pozitive si për kulturat lavëtarë (specat, domate, patate, bostan, qepë etj.) ashtu edhe për kultivimin e pemëve. Sipërfaqet bujqësore përfshijnë një sipërfaqe prej 19.998 ha dhe sipërfaqet janë të mbjella me këto kultura: gruri, elbi, tërshëra, misri, peme dhe perime, etj.

Sipërfaqet më pjellore janë rrafshinat e Anadrinit duke filluar prej Krushës së Vogël, Piranë, e Zojz e Medvec, deri te Korisha në veri dhe veri perëndim të qytetit të Prizrenit, e gjerë në Poslisht, Vlashnje, Zhur e Vermicë në jug. Në këto toka më së shumti kultivohen perimet dhe pemët, ndërsa në pjesët tjera në sasi më të vogël kultivohen edhe drithërat tjera si grurë, misër etj. Nga pemë të ndryshme më së shumti kultivohen këto produkte: molla, dardha, kumbulla, pjeshka, arra, kajsia etj., ndërsa nga perimet që kultivohen më së shumti janë: specat, domate, patate, bostan, qepë, pjepër etj.

Livadhet përfshijnë një sipërfaqe të konsiderueshme të komune së Prizrenit, ndërsa kullosat në këtë komunë zënë një hapësirë edhe më të madhe se livadhet. Këto sipërfaqe kanë ndikim në zhvillimin dhe mbajtjen e ekuilibrit të ekosistemit. Sipërfaqet të përgjithshme të përfshira me pyje janë 55-60 % e sipërfaqes së territorit të Prizrenit. Sipërfaqet e pyjeve përbëhen nga bungu, qarri, ahu, dushk, por ka edhe shkozë dhe frashër të zi. Ka sipërfaqe të tokave të zhveshura, të cilave në të ardhmen duhet ti kushtohet kujdes në pyllëzimin e sipërfaqeve të tilla. Me këto masa do të forcohet funksionimi i pyjeve në procesin e mbrojtjes së mjedisit (ambientit), në stabilitetin për formimin e kushteve klimatike që do të mundëson për

rekreacion. Funksioni i pyjeve është mjaftë me rëndësi për mbajtjen e ekuilibrit biologjik-ekologjik të këtij territori.

Në kuadër të florës së pasur me afro 2500 lloje të bimëve veçohen 323 bimë endemike që këtë territor e bënë tunikat në Ballkan, ndoshta edhe në Europë. Llojet më të rëndësishme drunore janë endem reliktet rrobulli (*Pinus heldreichii*) dhe arneni (*Pinus peuce*), ndërsa vlerë të veçantë kanë 20 lloje të bimëve steno-endemike: barpezmi i Aleksandrit (*Achillea alexandris regis*), bornmulera e Dieckit (*Bornmullera dieckii*), cerasti i Sharrit (*Cerastium neoscardicum*), karafil i Sharrit (*Dinathus scardicus*); draba e korabit (*Draba korabensis*); potentila e Doerflerit (*Potentilla doerfleri*); krokusi i Sharrit (*Crocus scardicus*); bar peshku i Sharrit (*Verbascum scardicum*), kokëz e Shmukerit (*Silene schmucherii*), kë mashna e Kobilicës (*Hieraceum kobilicanum*), kë mashna e Lubotenit (*Hieraceum naegelianum* supss. *Lubotenicum*), rrushqyqe (*Sedum flexuosum*), etj.

Sipas Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, por edhe sipas observimeve në terren, në lokacionin e projektit nuk ka zonë të mbrojtur, nuk ka lloje të mbrojtura, të rralla, apo endemike, dhe po ashtu nuk ka një potencial për vënie nën mbrojtje të zonës apo të ndonjë lloji, andaj ky impiant për prodhimin e betonit dhe elementeve nga betoni nuk do të sjell ndonjë problem në lokacionin ku është i vendosur.

4.8 Fauna

Në tërë territorin e komunës së Prizrenit rrjedh shume lumenj si, Drini Bardhë, Lumëbardhi i Prizrenit, lumi Toplluha, si dhe shumë përrrenj dhe përroska të cilët derdhen në këta lumenj që ka rëndësi të madhe ekonomike dhe në të gjenden numri i madh i llojeve të peshqve. Në Drinin e Bardhë ka më së shumti bërcak mustak, rapuli, marule, krap, ngjal dhe trofta e cila lajmërohet kohë pas kohe. Përafërsisht llojet e njëjtë të peshqve ndodhen edhe në lumenjtë tjerë. Përpos peshqve ka edhe bretkosa, gaforre dhe gjarpinj të ujit. Ndërsa në ekonominë familjare kultivohen gjedhet, kuaj, dele, dhi, derra si dhe shpezë.

Në territorin e komunës së Prizrenit sidomos në zonën e maleve të parkut Kombëtar “SHARRI”, janë prezentë edhe shtazët e egra siç janë: dhelpra, ujku, lepuri, derri i egër, ariu, dhi të egra, etj, po ashtu në këtë park ka edhe shume fruta të egër si: Boronica, mjedra, gështenja, thana, molla dhe dardha të egra, etj. Po ashtu edhe një numër i madh i bimëve shëruese si dhe po ashtu edhe një numër i konsiderueshëm i llojeve të kërpudhave.

Shpezë në territorin e komunës së Prizrenit, që janë më të njohura janë këto: thëllëza, sorra, harabeli, pata e egër, korbi, bylbylat, pëllumbat, kumria (*Gugutka*), skifteri (*gjeragina*), shqiponja, pulat e egra dhe lejleku gjatë stinës verore e posaçërisht përgjatë rrjedhjes së lumit Drini Bardhë.

Gjendja e tanishme e ekuilibrit biologjik-ekologjik të komunës së Prizrenit ka kushtet të përshtatshme për zhvillimin florës dhe faunës e cili do të do të vinte edhe me tepër në shprehje më rritjen e sipërfaqeve me pyje të llojeve të ndryshme të drunjtë, rruajtjen e gjendjes ekzistuese të peshqve dhe begatimi i tyre, kjo vlen edhe për llojet të ndryshme të shpezëve dhe egërsirave të cilat i ka ky territor.

Si pas vizitave ne terren zona ku është ndërtuar ky projekt është një zone e ndikuar nga faktori njeri, pasi qe ne afërsi te zonës operojnë një numër i konsiderueshëm i objekteve industriale dhe veprimtarive minerare.

4.9 Peizazhi

Peizazhi, paraqet një nga veçoritë e rëndësishme të cilat duhet trajtuar në kuadër të vlerësimit të ndikimeve në mjedis. Edhe pse si definicion, paraqet një tërësi të elementeve natyrore, me vlerë vizuale dhe relaksuese, qe d.m.th. në kuptimin e ndotjes dhe emisioneve nuk paraqet efekte direkt në shëndet, megjithatë kjo duhet trajtuar dhe vlerësuar me kujdes.

Rajoni i Prizrenit ka një ndër peizazhet më të mira në Republikën e Kosovës, me vendin më të ulët më lartësi mbi detare në Kosovë që është rreth 375 metër mbi nivelin e detit e cila ndodhet në Vermicë, e cila ndodhe ne jug-perëndim të qytetit të Prizrenit si dhe me vargmalet e Sharrit me lartësi mbi detare rreth 2500 metër mbi nivelin e deti, të cilat shtrihen nga lindja deri në jug të qytetit, prandaj kjo edhe bën që qyteti edhe rrethina e Prizrenit të ketë një peizazh shumë të mirë me bukuri të shumta natyrore. Këtu vlen të përmendët edhe Kalaja e Prizrenit dhe shumë monumente tjera historike që ndodhe në këtë qytet por edhe në rrethin.

Siç është përshkruar më lartë, lokacioni i projektit për impiantin për prodhimin e betonit dhe elementeve nga betoni nga është një lokacion kryesisht i rrafshet i rrethuar me objekte tjera industriale dhe banimi.

4.10 Ajri

Ajri i pastër është me rëndësi vitale për shëndetin e njeriut. Mirëpo, që nga revolucioni industrial kualiteti i ajrit që e thithim ka rënë konsiderueshëm kryesisht si rezultat i aktiviteteve njerëzore. Ngritja e prodhimit industrial dhe energjetik, djegia e karburanteve fosile, si dhe rritja dramatike e trafikut kanë shtuar edhe më shumë ndotjen e ajrit, çka si rrjedhojë mund të shkaktojë probleme shëndetësore serioze.

Rreziqet e ndotjes së ajrit për shëndetin janë kryesisht të lidhura me përqendrimet e PM, veçanërisht PM_{2.5}, që është klasifikuar si kancerogjen nga Agjencia Ndërkombëtare Kërkimore mbi Kancerin (IARC). PM_{2.5} depërtojnë thellë në mushkëri dhe dihet që kontribuojnë në sëmundjet e frymëmarrjes, sëmundjet kardiovaskulare dhe kancerin e mushkërive. Në sëmundjet e mushkërive kontribuon edhe dioksidi i karbonit, njëjtë si edhe ozoni, që ulin funksionimin e mushkërive dhe acarojnë astmën.

Ndotësit e ajrit klasifikohen në dy kategori. Kategoria e parë ka të bëjë me ndotësit parësorë, të cilët emetohen drejtpërdrejt përmes atmosferës. Kategoria tjetër janë ndotës dytësorë, të cilët nuk emetojnë nga burimet e tyre, por emetohen në atmosferë përmes reaksioneve me ndotësit parësorë.

Përderisa, sipas Agjencisë Evropiane të Mjedisit, burimet kryesore të ndotjes janë: - Transporti (transporti rrugor, ajror, hekurudhor dhe ujor), - Tregtia/Komercializmi (institucionale dhe ekonomitë familjare), - Energjia (prodhimi dhe shpërndarja), - Industria

(përdorimi i energjisë në industri, procese industriale dhe shfrytëzimin e produkteve), - Bujqësia dhe - Mbeturinat.

Duke i pasur për bëze të dhënat me lart rreth ndotjes së ajrit, vijmë në përfundim që edhe impiantet e prodhimit të betonit dhe elementeve nga betoni janë burim i ndotjes, nëse nuk përmbahen rregullave për ndotje të ajrit, e sidomos munden me qene kontribuues të mëdhenj në rritjen e PM në atmosferë.

Mirëpo kompania FORTESA BETON SH.P.K.. ka një impiant mjaft modern i cili i përmbush kriteret ligjore për të operuar, pasi që është i pajisur me filtra për parandalimin e hedhjes së pluhurit në atmosferë.

5. PROCESIT TEKNOLOGJIK I PRODHIMIT TË BETONIT DHE ELEMENTEVE NGA BETONI SI DHE PAJIMET

a. Objektet – pajimet e bazës së betonit

Impianti për prodhimin e betonit i kompanisë FORTESA BETON SH.P.K. do të përbëhet nga këto objekte dhe pajime:

- I. Objekti i administratës.
- II. Pajimet për prodhimin e betonit –përzërja bëhet në mikser, kapaciteti i prodhimit të betonit 60m³/orë, është prodhim Italian.
- III. Gropat për mbajtje të agregateve të rërës kapaciteti; 200 m².



Figura 7. Impianti i prodhimit te betonit dhe elementeve nga betoni FORTESA BETON SH.P.K.

- Bunkera $3 \times 5 \text{ m}^3 = 15 \text{ m}^3$ te agregatit: Fr I (0-4mm), Fr II (4-8mm), Fr III dhe IV (8-16mm dhe 16-31.5 mm).
- Silosi-Rezervari i çimentos 2 copë nga 65 tonë = 130.0 tonë
- Rezervari i ujit 10,000 lit
- Kërkesat për energji 200 Kw
- Transporteri përmbledhës horizontal nën bunker
- Transporteri i pjerrët furnizues i agregatit $L = 18\text{m}$; $B = 6500\text{mm}$;
- Kompresori për furnizim me ajër, $P = 4\text{kv} = 5040 \text{ lt/m}$
- Paneli komandues i bazës së betonit (kabina komanduese)
- Filtrat e siloseve të çimentos,
- Transporterët kërmillor të çimentos nga siloset, $L=18\text{m}$ dhe 7m
- Dozatori i çimentos
- Tre mikserët e Betonit me kapacitet 10m^3
- Një auto-pompë betoni
- Një lugë ngarkuese

Betoniera SIOME GRANDI IMPIANTI është adekuate për prodhimin e betonit dhe i përgjigjet ISO standardeve. Baza e betonit me pajimet përcjellëse për realizimin procesit teknologjik për prodhimin e llojeve të betoneve është e prodhuar në Itali.

b. Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit

Faza operative e një baze prodhimi betoni përfshin aktivitetet dhe proceset e përditshme të nevojshme për të prodhuar beton në mënyrë efikase dhe efektive.

Me poshtë do ti paraqesim karakteristikat kryesore të kësaj faze:

Përbërja dhe Përzierja: Prodhimi i betonit fillon me grumbullimin e saktë të lëndëve të para, duke përfshirë çimento, agregate (të tilla si rëra dhe zhavorri), uji dhe nganjëherë aditivët si përzierjet. Dizajni i përzierjes së betonit është thelbësor, dhe përbërësit duhet të maten me saktësi dhe të përzihen në përmasat e duhura për të arritur vetitë e dëshiruara të betonit. **Funksionimi i pajisjes:** Baza e prodhimit të betonit zakonisht përfshin funksionimin e pajisjeve të ndryshme, duke përfshirë impiantet e grumbullimit të betonit, miksera, transportues dhe kamionë. Këto makina duhet të mirëmbahen dhe operohen siç duhet për të siguruar prodhim të qëndrueshëm dhe me cilësi të lartë të betonit.

Kontrolli i cilësisë: Kontrolli i cilësisë është një aspekt kritik i fazës operacionale. Testimi dhe monitorimi i rregullt i vetive të betonit, të tilla si rrëshqitja, qëndrueshmëria në shtypje dhe punueshmëria, janë thelbësore për të siguruar që betoni përmbush specifikimet e projektimit dhe standardet e industrisë.

Masat e sigurisë: Sigurimi i sigurisë së punëtorëve është një prioritet kryesor gjatë fazës operacionale. Kjo përfshin sigurimin e pajisjeve të përshtatshme mbrojtëse personale, zbatimin e protokolleve të sigurisë dhe kryerjen e trajnimeve të rregullta të sigurisë.

Pajtuueshmëria mjedisore: Pajtuueshmëria me rregulloret mjedisore është jetike. Kjo përfshin menaxhimin e mbetjeve dhe rrjedhjeve, parandalimin e ndotjes dhe minimizimin e ndikimit mjedisor të procesit të prodhimit të betonit, ku duhet pasur kujdes në ruajtjen e tokës së shfrytëzuar ku është vendosur baza e betonit, ruajtjen e ujit nga ndotja dhe biodiversitetin.

Menaxhimi i inventarit: Menaxhimi efektiv i inventarit është thelbësor për sigurimin e një furnizimi të vazhdueshëm të lëndëve të para dhe ruajtjen e efikasitetit të prodhimit. Kjo përfshin monitorimin e niveleve të çimentos, agregateve dhe furnizimeve të tjera për të shmangur mungesat ose mbingarkesat.

Efikasiteti i Energjisë: Përdorimi efikas i energjisë është thelbësor për kursimin e kostos dhe qëndrueshmërinë mjedisore. Pajisjet dhe praktikat me efikasitet energjetik mund të reduktojnë kostot operacionale dhe të minimizojnë gjurmën e karbonit të prodhimit të betonit.

Mirëmbajtja dhe riparimet: Mirëmbajtja dhe riparimi i rregullt i pajisjeve janë thelbësore për të parandaluar prishjet dhe për të ruajtur vazhdimësinë e prodhimit. Duhet të kryhet mirëmbajtja e planifikuar për të mbajtur pajisjet në gjendje të mirë pune.

Dorëzimi i betonit: Koordinimi i dorëzimit në kohë të betonit në kantieret e ndërtimit është një pjesë kyçe e fazës operacionale. Kjo mund të përfshijë përdorimin e kamionëve të betonit, pompave ose metodave të tjera të transportit.

Mbajtja e të dhënave: Mbajtja e të dhënave të sakta të prodhimit të betonit, testeve të kontrollit të cilësisë, mirëmbajtjes së pajisjeve dhe procedurave të sigurisë është thelbësore për gjurmimin e performancës, sigurimin e llogaridhënies dhe përmbushjen e kërkesave rregullatore.

Përmirësimi i Vazhdueshëm: Faza operacionale duhet të përfshijë një kulturë të përmirësimit të vazhdueshëm. Rishikimi dhe optimizimi i rregullt i proceseve, pajisjeve dhe masave të sigurisë mund të çojë në rritjen e efikasitetit dhe kursimeve të kostos.

Pajtueshmëria me standardet: Respektimi i standardeve të industrisë dhe kodeve lokale të ndërtimit është thelbësor për të siguruar që betoni i prodhuar të plotësojë specifikimet e kërkuara për projekte të ndryshme ndërtimi.

Faza operative e një baze prodhimi betoni është një proces kompleks dhe dinamik që kërkon planifikim, monitorim dhe menaxhim të kujdesshëm për të prodhuar beton me cilësi të lartë në mënyrë efikase duke përmbushur standardet e sigurisë dhe mjedisit.

c. Koncepti prodhues i betonit

FORTESA BETON SH.P.K. planifikon prodhimin e betonit dhe elemente të parafabrikeve me teknologji dhe pajime të cilat mundësojnë prodhimin e të gjitha llojeve të betonit dhe me cilësi të lartë.

Në procesin e prodhimit të betonit, përdoren materialet: çimentoja, fraksionet e gurit / rërës, uji dhe aditivet.

Fraksionet e gurit / rërës të cilat do të përdoren janë: : Fr I (0-4)mm, Fr II (4-8)mm, Fr III(8-16)mm dhe Fr. IV(16-32)mm.

Teknologjia që do të përdoret, ofron mundësi të aplikimit të një procesi të mbyllur, me mundësi kontrollimi në mënyrë automatike, çka mundëson ndikime më të vogla në mjedis, si dhe efikasitet në përdorim të lëndës së parë. Impiant është prodhues Italian.

Figura 8 Vendasja e fraksioneve të zhavorrit në afërsi të Impiantit të prodhimit të Betonit

d. Prodhimi i betonit

Betoni paraqet konglomerat që përfitohet me përzierjen e çimentos, fraksioneve të gurit, dhe ujit. Kompania parasheh që të prodhojë këtë lloje të betoneve, varësisht prej kërkesave të tregut:

- Beton Plastik 0-16 (MB15, MB20, MB25, MB30, MB35, MB35)

- Beton Plastik 0-31.5 (MB10, MB15, MB20, MB25, MB30, MB35, MB 40)
- Beton i ajruar 0-16 (MB20, MB25, MB30, MB35, MB 40)
- Beton i ajruar 0-31.5 (MB20, MB25, MB30, MB35, MB 40)
- Beton i qëndrueshëm ndaj ujit 0-16 (MB20, MB25, MB30, MB35)
- Beton i qëndrueshëm ndaj ujit 0-31.5 (MB20, MB25, MB30, MB35)

Përveç llojeve të përmendura më lart, varësisht prej kërkesave të tregut, do të mund të prodhohen edhe lloje të tjera të betoneve për ndërtimin e rrugëve, urave, tuneleve, infrastrukturës nën ujore etj.

e. Komponentët e betonit

Çimentoja – paraqet komponentin lidhës të betonit. Kryesisht do të përdoret çimentoja “Portland”, por varësisht prej kërkesave të tregut mund të përdoren edhe lloje të tjera të çimentos. Cilësia e çimentos përcaktohet në bazë të aftësisë lidhëse, e cila shprehet përmes fortësisë. Kështu dallohen disa lloje të fortësisë: 200, 320, 500, 600 dhe 800 kp/cm². Sasia për prodhimin e betonit, përkatësisht harxhimi specifik i çimentos është 200-400 kg /1m³.

Agregati – guri / rëra. Kompania furnizohet me fraksionet e gurit gëlqeror nga kompani të, licencuara, materialet e të cilit janë dëshmuar për cilësi.

Agregati duhet të përmbushë kushtet e parapara në cilësi dhe granulim, duhet të jetë i pastër dhe me përbërje të lartë të kuarcit. Agregati duhet të jetë pa asnjë shtesë e cila do të mund të reagojë me ujin dhe të shkaktojë shkapërderdhje, sikurse që janë kloriket, sulfatet dhe kompozimet tjera kimike që mund të dëmtojnë vetitë fizike dhe mekanike të betonit.

Uji – është komponent i rëndësishëm në procesin e prodhimit të betonit, i cili shërben për të realizuar lidhjen e komponentëve të tjera, çimentos dhe agregatit. Investitori, siguron ujin nga pusi privat, dhe përmes depozitimit të rezervave të ujit në rezervuar.

Në procesin e prodhimit të betonit, përdoret vetëm ujë i pastër, pa materie organike.

Harxhimi specifik i ujit në procesin teknologjik për prodhimin e betonit varet nga lloji i betonit që dëshirojmë të prodhojmë. Në vijim do të i përshkruajmë ujit në beton në varësi nga lloji i betonit:

- | | |
|------------------------------|--------|
| - për beton të lëngshëm | 6- 8 % |
| - për beton plastik | 7- 9 % |
| - për beton të fortë plastik | 8-10 % |

Si që kemi cekur ne pasuset e më sipërme ne këtë betonier mund të prodhojmë beton të kualiteteve të ndryshme duke u bazuar në destinimin e tij dhe atë sipas nevojës dhe kërkesave të hargjuesve të betonit.

Në tabelën e më poshtme po e japim një shembull që paraqet sasinë e agregatit sipas fraksioneve dhe atë pa fraksionin + 16 - 31.5mm, sasinë e çimentos dhe sasinë e ujit që nevojitet për prodhimin e 1m³ beton llojit MB-30, sipas recepturës së caktuar:

Agregati

Fraksionet	+0-4mm	+4-8mm	+8-16mm		
Përqindja	45%	20%	35%		
Sasia	824kg	366kg	642kg	=	1832kg
Çimentoja					350kg
Uji					238kg

Nga kjo recepturë e lartshënuar mund të caktohet edhe bilanci material për prodhimin e 1m³ beton që shihet në tabelën e më poshtme.

Tabela 3. Tabela 2 Bilanci për prodhimin e 1 m³ beton MB-30

Hyrtja		Dalja	
Agregati	1832kg	1m ³ beton	2420kg
Çimentoja	350kg		
Uji	238kg		
Bilanci i përgjithshëm	2420kg		2420kg

Në tabelën ne vijim po e japim një shembull për sasinë e agregatit sipas fraksioneve dhe atë me katër fraksione, sasinë e çimentos dhe sasinë e ujit që nevojitet për prodhimin e 1m³ beton llojit MB-30, sipas recepturës së caktuar:

Agregati

fraksionet	+0-4mm	+4-8mm	+8-16mm	+16-31,5 mm		
përqindja	40%	15%	35%	25%		
sasia	756kg	283kg	378kg	473kg	=	1890kg
Çimentoja						320kg
Uji						220l

Nga kjo recepturë e lartshënuar mund të caktohet edhe bilanci material për prodhimin e 1m³ beton që shihet në tabelën e më poshtme.

Tabela 4. Tabela 4 Bilanci për prodhimin e 1 m³ beton

Hyrja		Dalja	
Agregati	1890kg	1m ³ beton	2430kg
Çimentoja	320kg		
Uji	220l		
Bilanci i përgjithshëm	2430kg		2430kg

f. Përshkrimi i procesit teknologjik i prodhimit të betonit

Procesi fillon me depozitim të lëndës së parë, në lokacione – objekte përkatëse. Fraksionet e agregatit, sipas porosisë, depozitohen në deponë të agregatit, dhe pastaj me makineri përkatëse

– lugë ngarkuese vendosen në silosin (bunkerin) të agregatit me kapacitet 15m³, sipas fraksioneve. Çimentoja e siguruar vendoset në dy siloset me nga 130 tona, ndërkohë që uji në rezervuarin e ujit 10000 litra.

Natyrisht në sistem bëjnë pjesë edhe pompa për furnizim me ujë si dhe pajisje elektrike automatike të dozimit.

- Agregatet e vendosura në silos sipas fraksioneve, dozohen përmes dozuesve elektropneumatik, të cilët hapen dhe mbyllen në mënyrë automatike varësisht nga komanda e dhënë, dhe njëkohësisht bëjnë matje të peshës së agregatit. Sasia e caktuar e agregatit
- kalon në shiritin transportues, i cili ndodhet nën siloset e agregatit, dhe i cili e transporton agregatin deri te shiriti kryesor, e që ky i fundit e përcjell lëndën deri në mikser.
- Dozimi i çimentos bëhet përmes peshorës automatike për matjen e peshës, si dhe transportohet përmes transportuesit kërmillor nga silosi. Çimentoja nga peshorja kalon në mënyrë automatike. Gjatë zbrazjes së peshorës së çimentos, aktivizohen vibruesit, të cilët sigurojnë që të gjithë sasia e çimentos të jetë larguar nga peshorja.
- Edhe dozimi i ujit bëhet në mënyrë automatike, me dozim të programuar përmes pompës së ujit. Pas kalimit të sasisë së programuar të ujit, ventili mbyllet në mënyrë automatike.

E tërë lënda e programuar dhe e peshuar: agregati nga siloset, përmes shiritit transportues e deri në shiritin kryesor; çimentoja gjithashtu nga peshorja, përmes gypit transportues e deri në shiritin kryesor, e gjithashtu edhe uji i programuar dhe dozuar, shkarkohen në mikser (përzier).

Pajimet mund të funksionojnë në mënyrë automatike me dozim të programuar, por gjithashtu mund të funksionojnë edhe në mënyrë manuale. Menaxhimi i tërë procesit kryhet nga kabina e kontrollit, përmes pultit automatik komandues. Modulet hyrëse drejtpërdrejtë pranojnë

sinjalet nga dozatorët dhe peshoret. Modulet digjitale dalëse, shërbejnë për menaxhimin e ventileve elektromagnetik, motorëve si dhe llampave sinjalizuese.

Përveç materialeve kryesore, agregatit, çimentos dhe ujit, në proces përfshihen edhe aditivët. Sidomos në sezonën e dimrit, si dhe për konstruksione të veçanta shtohen aditiv të cilët e shpejtojnë kohën e ngurtësimit. Aditivi kryesisht shtohet me ujë, ose drejtpërdrejtë në mikser. Zakonisht aditivët shtohen në masën 2-4% të masës së çimentos.

Para se të lëshohen pajimet për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit, duhet të kryhen këto veprime;

- Duhet të sigurohet sasia e mjaftueshme e agregatit në silose.
- Duhet të sigurohet sasia e mjaftueshme e çimentos dhe duhet hapur vetëm ventilin e silosit nga i cili dëshirojmë të marrim çimento.
- Duhet të sigurohet sasia e nevojshme e ujit.
- Duhet caktuar recepturën për kualitetin e betonit të cilin dëshirojmë të e prodhojmë
- Të caktohet zgjatja e kohës së ciklit të prodhimit të betonit duke u bazuar në recepturën e caktuar.

Pajimet mund të funksionojnë në mënyrë automatike me dozim të programuar dhe në mënyrë manuale. Menaxhimi i procesit teknologjik i prodhimit të betonit, kryhet nga pulti komandues i automatizuar i vendosur në dhomën (hapësirën) të caktuar për te. Modulet hyrëse drejtpërdrejt pranojnë sinjalet nga dozatorët dhe peshojat, nëpërmjet sondave për të gjithë komponentët e procesit të prodhimit. Modulet digjitale dalëse shërbejnë për menaxhimin e ventileve elektromagnetikë, motorëve si dhe llampave sinjalizuese. Menaxhimi i ter procesit të prodhimit behet edhe përmes disa monitorëve të vendosur ne panelin e komandimit, përmes këtij paneli operatorit i mundësz të bëj mbikëqyrjen e ter procesit dhe recepturat për prodhimin e betonit, me këte mundësohet matja lehtë e komponentëve të agregatit, bitumenit dhe komponentëve tjera shtesë.

Për të arritur cilësinë e duhur të betonit bëhet sitja e çimentos me sita standarde dhe përcaktohet kohëlidhja e sajë. (Kohëlidhja e çimentos paraqet kohën nga momenti i përzierjes së çimentos me ujë gjer në momentin e fillimit të hidratimit të sajë dhe arritjes së fortësisëpërkatesë).

g. Përshkrimi i procesit teknologjik i prodhimit te elementeve nga betonit

1. Përgatitja e linjës së prodhimit;
2. Kontrolli i pajisjeve teknologjike;
3. Kontrolli i posteve të punës;
4. Kontrolli i sistemit të sigurisë;
5. Kontrolli i sistemit të mbrojtjes nga zjarrit;

Linja e prodhimit të produkteve nga betoni

1. Vibropresa statike për prodhim të kabëzave dhe anësoreve të betonit

2. Kompresori për ajrin e komprimuar
3. Magazinimi i produkteve të prodhuara nga betoni

Vibropresa statike për prodhim të gypave, kubzave dhe ansoreve të betonit, Procesi i prodhimit të elementeve nga betoni, Faza e parë është mbushja me përzierje betoni në presën për prodhimin e elementeve nga betoni. Betoni nga betoniera me anë të lopatës ngarkuese sjellet gjer të makinat për prodhimin e gypave, kubzave dhe anësoreve. Kallupet vibrohen në atë mënyrë që të mund të bëhet shpërndarja e njëtrajtshme e masës së betonit dhe me anë të shtypjes kalon në kallupet e vendosura në makinë varësisht nga produkti se cilin dhe të cilës madhësi dëshirojmë të e prodhojmë. Elementet e betonit largohen nga kallupet kur ato të ngritën dhe largohen së bashku me paisje dhe produktet mbeshin mbi tavolinën punuese deri sa të marrin fortësinë e nevojshme, pastaj produkteve të formësuar me anë mekanike i bëhet renditja, paketimin e prodhimit në paleta, pastaj përmes dërgohet në tertore e pastaj me anë të pirunit, dërgohen në deponin për prodhimet e gatshme në ambientet e jashtme. Llojet e elementeve nga betoni që prodhohen nga subjekti:

- Gypat e betonit të dimensioneve të ndryshme. Gypa të armuar të betonit të prodhuara me metoda centrifugale me gjatësi deri 2.5m të lidhura me unaza gome. Gypa të prodhuara nga vibropresa të cilët përmes vibrimit dhe presionit e bëjnë kompaktësinë e betonit. Gypa të betonit nga betoni i paratensionuar. Gypa të dimensioneve:
 - ✓ Gyp betoni fi 300mm
 - ✓ Gyp betoni fi 500mm
 - ✓ Gyp betoni fi 800mm
 - ✓ Gyp betoni fi 1000mm
 - ✓ Gyp betoni fi 1500mm

Gypat e betonit kanë gjatësi nga 200mm deri në 2500mm.

- Anësoret e betonit
 - ✓ Anësorë 18/24/12 (dim. cm: 18 x 24 x 12 x 100)
 - ✓ Anësorë pjesë 18/24/12 (dim. cm: 18 x 24 x 12 x 20)
 - ✓ Anësorë 12/24 (dim. cm: 12 x 24 x 100)
 - ✓ Anësorë 8/20 (dim. cm: 08 x 20 x 100)
 - ✓ Anësorë 18/24/15 (dim. cm: 18 x 24 x 15 x 100) dhe
 - ✓ Anësorë pjesë 18/24/15 (dim. cm: 18 x 24 x 15 x 20)
- Kubëza betoni
 - ✓ Modeli H (Dim: 20x16.5x8 cm)
 - ✓ Modeli Tull 20/10 (Dim. 20x10x8 dhe 20x10x6 cm)
 - ✓ Modeli Gjashtëkëndësh (Dim: 20 x 23 x 8 cm) dhe
 - ✓ Modeli Katërkëndësh 12/16 (Dim: 12 x 16 x 8 cm)
- Ujorë betoni
 - ✓ Ujorë Betoni 30/10 (30 x 10 x 30 cm) dhe
 - ✓ Ujorë Betoni 40/12 (40x 12 x 30 cm)

Përpos pajisjeve të lartë cekura për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit dhe produkteve nga betoni dhe për bartjen e betonit dhe produkteve nga betoni gjer te harxhuesi (konsumatori), kompania disponon edhe këtë mekanizëm: kamionë për bartjen e produkteve nga betoni, një piruner. Bazuar në kërkesat dhe përvojën e punës në këtë betonier dhe repartin për prodhimin e produkteve nga betoni punët janë të organizuara vetëm në ndërrimin e parë. Fuqia punëtore e angazhuar është e konsiderueshme dhe ka ndikim pozitiv në punësimin e popullatës.




Figura 9. Figura 11 Skema e procesit teknologjik

6. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME

Gjatë zgjedhjes së një vendi për ndërtimin e një baze prodhimi betoni dhe elementeve nga betoni, është thelbësore të merren parasysh alternativa të ndryshme të arsyeshme për të siguruar zgjedhjen e vendndodhjes optimale.

Më poshtë do të japim një përshkrim të disa prej alternativave të arsyeshme që duhen marrë parasysh gjatë procesit të përzgjedhjes së lokacionit:

a. Zonat me industri te njëjta ekzistuese:

Përdorimi i një zone me industri ekzistuese te njëjta mund të jetë një alternativë me kosto efektive. Zona të tilla mund të kenë tashmë infrastrukturë, shërbime komunale dhe lidhje transporti, duke reduktuar kostot fillestare të konfigurimit. Ne komunën e Prizrenit janë planifikuar disa zona industriale/ekonomike me planin zhvillimor komunal disa janë parapare përgjatë rrugës regjionale, lokacioni ku është planifikuar ndërtimi i bazës së prodhimit të betonit dhe elementeve nga betoni i përket një zone me industri te ndryshme.

b. Sipërfaqet e fushave te gjelbërta:

Vendet e fushave te gjelbërta janë tokë të pazhvilluar. Ndërsa mund të kërkojnë më shumë investime fillestare në infrastrukturë, ato ofrojnë një fushe të zbrazët për projektimin e një objekti prodhimi betoni sipas specifikave tuaja të sakta.

c. Afërsia me lëndët e para:

Përzgjedhja e një vendi afër burimeve të lëndëve të para thelbësore, të tilla si agregatet dhe çimentoja, mund të zvogëlojë kostot e transportit dhe të rrisë efikasitetin operacional.

d. Infrastruktura e transportit:

Afërsia me rrugët kryesore është thelbësore për shpërndarjen efikase të produkteve të betonit. Është konsideruar se lokacioni i bazës së prodhimit të betonit dhe elementeve nga betoni ka akses të mirë në rrugët kryesore, lokale dhe ne autostrade.

e. Ndikim mjedisor:

Vlerësimi i ndikimit mjedisor të secilit vend, duke marrë parasysh faktorë si cilësia e ajrit dhe ujit, ruajtja e habitatit dhe kërkesat e mundshme të rehabilitimit.

f. Zonimi dhe rregulloret:

Hetoni rregulloret lokale të zonimit dhe kërkesat e lejeve për çdo vend të mundshëm. Sigurohuni që operacionet tuaja do të jenë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse.

g. Marrëdhëniet me komunitetin:

Vlerësimi i pranueshmërinë se komunitetit ndaj një objekti për prodhim betoni. Marrëdhëniet e mira me komunitetin janë thelbësore për të shmangur konfliktet dhe për të siguruar një proces më të qetë të lejeve.

h. Shërbimet komunale dhe infrastruktura:

Kontrolloni disponueshmërinë dhe kapacitetin e shërbimeve, duke përfshirë ujin, energjinë elektrike dhe sistemet e ujërave të zeza, në çdo vend. Përmirësimi ose instalimi i shërbimeve mund të jetë i shtrenjtë.

i. Kushtet gjeologjike dhe gjeoteknike:

Kryerja e studimeve të tokës dhe gjeoteknike për të siguruar që vendi i zgjedhur mund të mbështesë makineritë dhe strukturat e rënda të nevojshme për prodhimin e betonit dhe elementeve nga betoni.

j. Kërkesa e tregut:

Analizoni kërkesën për beton në rajon. Një faqe që është më afër tregut tuaj të synuar mund të zvogëlojë kostot e transportit dhe të rrisë konkurrencën.

6.1 Mbrojtje dhe siguri:

Është marrë parasysh siguria e zonës për sa i përket rreziqeve të fatkeqësive natyrore, shkallës së kimit dhe shqetësimeve të tjera të sigurisë. Kjo është thelbësore për sigurinë e personelit dhe pajisjeve.

6.2 Potenciali i zgjerimit:

Është bërë vlerësimi, nëse vendi i zgjedhur lejon zgjerimin e ardhshëm, nëse biznesi i prodhimit të betonit dhe elementeve nga betoni rritet. Kostoja e tokës dhe e ndërtimit: Llogaritja e kostos së blerjes së tokës dhe ndërtimit në çdo vend, duke marrë parasysh jo vetëm çmimin e blerjes, por edhe kostot e zhvillimit të infrastrukturës.

6.3 Logjistika dhe vendi i lokacionit:

Duhet të vlerësohet se sa me efikasitet mund të rrjedhin materialet nëpër vend, duke përfshirë ruajtjen, grumbullimin dhe shpërndarjen.

6.4 Qëndrueshmëria mjedisore:

Duhet të merren parasysh praktikat e qëndrueshme mjedisore dhe burimet e rinovueshme të energjisë kur zgjidhni një vend për të reduktuar gjurmën e karbonit të objektit.

6.5 Afërsia me fuqinë punëtore:

Duhet siguruar që ka një fuqi punëtore të disponueshme dhe të kualifikuar në afërsi të kantierit për të mbështetur operacionet tuaja të prodhimit konkret.

Duke marrë parasysh këto alternativa të arsyeshme dhe duke vlerësuar tërësisht secilën prej tyre, kompania FORTESA BETON SH.P.K. nuk e ka pasur te vështirë të merr një vendim të informuar për vendndodhjen më të përshtatshme për bazën e prodhimit të betonit dhe elementeve nga betoni. Kompania e ka parë te rëndësishme dhe ka angazhuar ekspertë të cilët kanë kryer studime gjithëpërfshirëse të fizibilitetit për të zgjedhur lokacionin që përputhet më mirë me qëllimet dhe vlerat e biznesit të kompanisë FORTESA BETON SH.P.K..

Andaj duke i marre parasysh të gjitha alternativat e me sipërme është përzgjedhur lokacioni i bazës së prodhimit të betonit dhe elementeve nga betoni nga kompania FORTESA BETON SH.P.K., e cila ka qasje të mirë me autostraden “Ibrahim Rugova”, ka energjinë elektrike afër po ashtu ka edhe ujera nëntokësorë në sasi të mjaftueshme e cila ka planifikuar hapjen e pusit nëntokësor.

7. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Shkarkimet në mjedis gjatë funksionimit të impiantit të prodhimit të betonit elementeve nga betoni do të jenë kryesisht pluhuri i lëndës së parë si granil dhe rërë, si dhe zhurma e impiantit dhe në rast të mundshëm derdhje të çimentos në sheshin e prodhimit. Procesi i prodhimit të betonit dhe elementeve nga betoni përfshinë edhe përdorimin e ujit, si pjesë e procesit teknologjik, kjo shërben për tretjen e çimentos dhe furnizimin e autobetonierëve me ujë për procesin e lagjes së materialit të përzier. Proces tjetër është edhe larja e pastrimi i autobetonierëve pas shkarkimit të betonit, në mënyrë që të mos ngrije materiali në depozitën e përzierësit të betonit dhe të krijoj problem gjatë punës. Këto ujëra do të jenë me përmbajtje çimentoje, gëlqere dhe solucione ndihmëse për ngrirjen e betonit. Për këtë arsye, drejtuesit e këtyre mjeteve duhet të trajnohen për të kryer këtë proces në kantierin e prodhimit, ti shkarkojnë ujërat në vaskën e dekantimit dhe jo në çdo mjedis të mundshëm sipas rastit.

a. Ndikimet në ajër

Gjatë fazës së operimit, prodhimit të betonit elementeve nga betoni, ndikime negative në ajër mund të paraqiten nga procesi teknologjik, nga ku lirohen grimca të pluhurit të çimentos si dhe grimca të pluhurit të agregatit që përdoret për prodhimin e betonit dhe elementeve nga betoni. Këto grimca mund të emetohen në ajër, dhe pastaj për shkak të peshës së tyre gravitojnë në tokë, në afërsi të impiantit. Këto pluhura përmbajnë substanca kimike të njëjta me çimenton si dhe me agregatin nga i cili janë liruara. Në kushte të mos ndërmarrjes së

masave zvogëluese, si rezultat i relievit dhe kushteve tjera mjedisore, këto grimca mund të barten edhe në distanca më të largëta.

Gjithashtu, pluhur mund të ngritët edhe nga deponia e agregatit, si dhe nga pluhuri i liruar nga shiritat transportues. Ndotje e ajrit mund të rezultojë edhe gjatë depozitimit të çimentos në silos, gjatë ngarkim shkarkimit si dhe transportimit.

Nivel më pak relevant i ndotjes së ajrit mund të vije edhe nga emisionet e gazrave të automjeteve që përdoren, si lugë ngarkuese automikser etje.

b. Ndikimet në tokë

Në dobi të minimizimit të ndikimeve në tokë, investitori do të kujdeset që gjatë gërryerjes dhe rrafshimit të tokës të punon në mënyrë profesionale ndërsa pjesë të caktuara sipas organizimit brenda parcelës do të shtrohen me zhavor dhe me beton. Njëkohësisht hapësirë e konsiderueshme e parcelës planifikohet të mbillet me pemë pas analizës së substratit.

Nga fakti se në afërsi të hapësirës ku planifikohet të ndërtohet impianti nuk ka burime të ujit të pijshëm dhe burime të ujërave nëntokësore të cilat do të mund të dëmtoheshin nga aktivitetet e këtij biznesi, mund të konkludojmë se ndikimet do të jenë minimalë.

Për minimizimin e ndikimeve do të ndërmerren masat si në vijim:

- Do të përdoren makineri të cilat teknikisht do të jenë të kontrolluara, veçmas nuk do të lejohen makineri me rrjedhje vaji.
- Në zonë nuk do të lejohet shtimi, ndërrimi, vendosja e vajrave apo karburanteve
- Do të ndërtohet gropa septike, në të cilën do të grumbullohen ujërat e impiantit, për mes se cilës grope fundërrimin i grimcave në mënyrë që uji të përdoret prap në procesin e prodhimit.

Gjatë fazës së operimit – prodhimit të betonit dhe elementeve nga betoni, ndikime negative në tokë paraqiten nga mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të ndryshme; si dhe nga mbetjet e ushqimit dhe paketimet që mund të rezultojnë nga stafi / punëtorët.

Ndikim tjetër në tokë mund të vije edhe nga depozitimi i pluhurave të rezultuara nga agregati dhe çimentoja, si dhe ndikimet nga mbeturinat e ngurta dhe të lëngëta që krijohen nga larja e makinave prodhuese, auto-mikserëve, dhe automjeteve tjera transportuese.

c. Ndikimet në ujë

Shkarkimet në ujë mund të vijnë nga:

- Derivatet, vajrat dhe lubrifikantet të ndryshme të cilat mund të derdhen nga makinat prodhuese
- Pastrimi i ambientit në rast të shkarkimit të çimentos së lëngshme, kryesisht nga ndërprerja e punës për shkak të ndërprerjeve të energjisë elektrike ose avari te tjera.

- Në rastet e pastrimit të automjeteve të transportit në ambientin e kantierit, larja e auto- betonierëve dhe e materialit të gurit gëlqeror.
- Ujerat e lagies së sheshit të qarkullimit të automjeteve.
- Ujerat e përdorur për ambientet hijeno-sanitare të ambientit të stafit
- Ujerat nga shpëlarja e materialit nga reshjet.

Ndikimi i këtij aktiviteti në ujera konsiston në ujerat e pastrimit të ambientit të punës. Procesi teknologjik uji shkarkohet vetëm gjatë shpëlarjes së makinerive, mirpo uji pasi të trajtohet në Sedimentues, prapë rikthehet në proces teknologjik.

Ndërsa për ujërat fekale kompania ka marrë pëlqim për tu lidhur në rrjetin e kanalizimit të ujërave të zeza të qytetit.

d. Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë

Në baze të dhënave që kemi gjetur nga raportet komunale por edhe në daljes në teren lokacion nuk është i evidentuar si zonë e mbrojtur e natyrës dhe as si zonë e propozuar për mbrojtje. Po ashtu kjo zonë nuk njihet si lokalitet ose habitat i llojeve të rralla bimore dhe shtazore. Megjithatë, në nivel të mikro sistemit dhe të habitatit lokal në sipërfaqe ku do të operoj impianti, nuk do të ketë kushte për zhvillim të florës dhe faunës.

e. Ndikimi në vendbanime dhe popullatë

Nga ky impiant për prodhimin e betonit dhe elementeve nga betoni nuk pritet që të ketë zhvendosje të popullsisë, çrregullim të vendbanim apo çfarëdo efekti tjetër.

Nga veprimtaria e këtij aktiviteti mund të ndikohen objektet për rrethe nga pluhuri eventuale, si dhe nga zhurma. Masa të veçanta duhet të ndërmerren në këtë drejtim.

Megjithatë, këto ndikime nuk janë të theksuara. Mund të thuhet se ka ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik të zonës dhe ndihmon në punësimin dhe mbështetjen e komunitetit lokal.

f. Ndikimi nga zhurma

Zhurma si rezultat i teknologjisë së prodhimit të betonit dhe elementeve nga betoni do të ketë një karakter lokal dhe nuk do të ketë ndikim në zonat e banuara. Zhurma do të krijohet nga makineritë dhe pajimet e procesit të prodhimit të betonit dhe elementeve nga betoni, automjetet transportuese dhe automjete të tjera.

Sidoqoftë, aktivitetet që zhvillohen në këtë biznes nuk pritet që të tejkalojnë nivelin e lejuar të zhurmës. Zhurma dhe vibrimet që krijohen gjatë punës nuk pritet të ndikojnë në popullatën lokale. Po ashtu gjatë zhvillimit të veprimtarisë nuk ka aktivitete që zhvillohen gjatë natës që mund të ndikojnë në krijimin e zhurmave.

Sa i përket zhurmave, ato janë të ndjeshme vetëm brenda ambienteve të fabrikës dhe nuk janë problem për mjediset e jashtme dhe fqinjët.

g. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Sipas natyrës së impiantit, nuk pritët përdorim i lendeve e as prodhim i produkteve të cilat kanë rrezikshmëri të lartë për mjedisin. Aksidentet që mund të ndodhin mund të jenë të natyrave të ndryshme dhe mund të ndodhin në çdo kohë të procesit teknologjik si:

- Rrjedhjet e ndryshme të lendeve djegëse dhe lubrifikuese
- Nga mekanizimi punues
- Mundësia e pëlcitjes së gypave hidraulik
- Aksidentet e mundshme në komunikacionin gjatë transportit të lëndës së parë, betonit dhe elementeve nga betoni etj.

8. MASAT PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE NË MJEDIS

a. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër

Për të parandaluar dhe zvogëluar ndikimet negative në ajër gjatë fazës së operimit, përkatësisht prodhimit të betonit dhe elementeve nga betoni, për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në ajër duhet të ndërmerren këto masa:

- Pluhuri i cili lirohet gjatë procesit teknologjik të prodhimit duhet të mënjanohet apo zvogëlohet deri në kufijtë minimal dhe pa ndikime në mjedis dhe shëndet.
- Shiritat transportues të fraksioneve duhet të jenë të mbuluar, dhe të mirëmbajtur.
- Gypat për mbushje të siloseve me çimento, si dhe gypa për mbushjen e mikserit me çimento duhet të jenë të kontrolluar, dhe pjesët lidhëse të tyre të jenë të mbyllura dhe të siguruar mirë
- Thasët e filtrave të kontrollohen rregullisht dhe nëse dëmtohen duhet të ndërrohen.
- Të bëhet kontrolli i rregullt teknik i automjeteve transportuese
- Vazhdimisht të spërkatën me ujë platoja operationale, aty ku ka potencial për pluhur, sidomos gjatë kohës me erëra dhe me temperatura të larta.

b. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë

Për të parandaluar dhe zvogëluar ndikimet në tokë, gjatë fazës së operimit, prodhimit të betonit dhe elementeve nga betoni, duhet të ndërmerren masat si në vijim:

- Të gjitha pajimet, stabilimentet e nevojshme për procesin e prodhimit të mirëmbahen dhe kontrollohen rregullisht

- Filtrat e silosit të çimentos duhet të kontrollohen dhe nëse janë dëmtuar të ndërrohen
- Të kontrollohen gypat transportues si dhe shiritat transportues. Vendet e lidhjes së gypave duhet të jenë të puthitura mirë në mënyrë që të parandalohet rrjedhja e materialeve.
- Të bëhet betonimi i platosë ku bëhet vendosja e pajimeve për prodhimin e betonit, dhe elementeve nga betoni gjeneratori, depot e vajrave e lubrifikantëve dhe të pajimeve tjera, si mjete sekondare të punës
- Ndërrimi i vajrave të makinave të bëhet në vende të posaçme, të betonuara dhe të izoluara,
- Mbeturinat e ngurta duhet të grumbullohen dhe klasifikohen sipas llojit dhe përbërjes. Ato që nuk mund të ripërdoren apo të shiten duhet të dërgohen në deponime regjionale të mbeturinave
- Mbeturinat komunale duhet të vendosen në kontejner adekuat të mbuluar me kapak, dhe duhet të bëhet marrëveshje me kompaninë komunale për mbledhje të mbeturinave.
- Vajrat e përdorura duhet të vendosen në enë të vecant dhe t'u shiten kompanive të licencuara për mbledhjen e vajrave të përdorura

Paraqitja e mbeturinave sipas katalogut shtetëror:


Mbeturinat sipas katalogut shtetëror			
Numri sipas katalogut shtetëror te mbeturinave	Emri i Mbeturinës	Shkalla e Rrezikshmërisë	Lloji i planifikuar për Deponim te mbeturinave
20 01 01	Letër dhe karton	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina
20 03 01	Mbeturina te përziera komunale	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina
20 01 39	Plastika	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina

c. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë

Për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve negative në ujëra, duhet ndërmarrë këto masa:

- Në lokalitetin e betonierkës duhet të behët sistemi për bartjen dhe grumbullimin e ujërave të ndotura të krijuara nga procesi i prodhimit, nga larja e automjeteve transportuese, automiskerëve apo automjeteve të tjera, si dhe të ujërave të reshurave atmosferike.
- Duhet rregulluar sistemin gypor për bartjen e ujërave të cilat duhet të barten në puse sedimentuese për trajtimin e ujërave, përkatësisht për sedimentimin e grimcave të ngurta

- Kolektorët duhet të rregullohen ashtu që e tërë sasia e ujërave industriale si dhe të të reshurave nga platotë dhe nga tërë sipërfaqet funksionale të grumbullohen dhe të orientohen në pusët sedimentuese, e pastaj në separator.
- Duhet të ndërtohen tri puse sedimentuese në mënyrë që të sedimentohen grimcat e ngurta
- Duhet të ndërtohet separatori i vajrave në mënyrë që ujërat të pastrohen nga vajrat që kanë rrjedhur nga sipërfaqet operationale, makineritë prodhuese, automjetet etj. Separatori duhet të ndërtohet ashtu që rregullisht të mund të kontrollohet dhe të merren mostrat,
- Pusët sedimentuese dhe separatori duhet rregullisht të pastrohen nga mbeturinat. Mbeturinat duhet të dërgohen në deponi regionale.
- Ujërat e zeza duhet të trajtohen përmes gropës septike. Pastrimi i gropës septike duhet të bëhet nga kompanitë publike për ujësjellës dhe kanalizim.
- Kompania duhet që të matjen e cilësisë së ujërave të shkarkuara, dhe se vlerat e fituara duhet të krahasohen me vlerat e caktuara me udhëzimin administrativ 13 / 2008. Vlerat e cilësisë së ujit të shkarkuar nuk guxojnë të jenë më të larta se ato të përkufizuara në udhëzim administrativ.



Sedimentuesi i ndërtuar nga kompania për trajtimin e ujërave nga baza për prodhimin e betonit

d. Masat për mbrojtjen nga zhurma

Kompania duhet të bëjë matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Matjet duhet të bëhen afër vendbanimeve, në mënyrë që të vërehen ndikimet në vendbanim. Në rast se rezultatet e matjeve tregojnë vlera më të larta sesa ato të lejuarat, atëherë kompania duhet të ndërmarrë masat e duhura.

Varësisht prej procesit të punës, në mjediset ku parashihet zhurmë e madhe, punëtorët duhet të bartin pajisje për mbrojtje nga zhurma.

e. Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet

Për të parandaluar pasojat e mundshme, kompania duhet të zhvilloj plan të menaxhimit të rrezikut nga aksidentet mjedisore. Gjithashtu duhet të përgatit një plan për parandalimin e zjarrit, por edhe plan për menaxhimin e situatave në raste të zjarrit.

Si masë parandaluese, i tërë lokacioni duhet të jetë i rrethuar, mbrojtur nga ndikimet fizike të jashtme. Duhet të vendosen rrethoja adekuate. Duhet të merren masat e sigurisë për evitimin e derdhjes së vajrave apo derivateve.

Duhet që të ndërmerren të gjitha masat e sigurisë, konform ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe të mjedisit të punës.

9. PROGRAMI I MONITORIMIT

Duke e pasur parasysh se ky aktivitet nuk parasheh përdorim të lëndëve djegëse, nuk parasheh procese të djegies, shkrirjes, apo furra me temperatura të mëdha, si dhe nuk parasheh shkarkime të ujërave të zeza nga proceset teknologjike, nuk konsiderohet e detyrueshme monitorimi permanent i tregueseve mjedisor. Megjithatë, rekomandohet që në mënyrë periodike, investitori të monitorojë këto tregues të trysnisë në mjedis:

- Për ajrin duhet të monitoroj Lëndën e Ngurtë Pezull (LNP) dhe zhurmat në ambientin e punës (dB).
- Për ujin: lënda e ngurtë pezull, përmbajtja e CaCO₃.
- Për token, nuk aplikohen detyrime monitorimi

10. RAPORTIMI

Raportimi do të kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxhmenti, gjegjësisht nga ekspertët e kompanisë. Në raport do të përfshihen të dhënat për monitorimin siç do të jetë kërkuar në pëlqimin mjedisor, përkatësisht lejen mjedisore.

11. MASAT REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETIT

Pas përfundimit të aktivitetit prodhues, pajimet e impiantit duhet të çmontohen dhe të largohen nga ky lokalitet. Bazamentet si dhe platotë ng betoni duhet të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponinë regjionale. Substratet e krijuara gjatë procesit të prodhimit, përmbajnë rërë, zhavorr, çimento beton etj. Ato duhet të largohen, dhe me një trashësi rreth 0.5 m struktura përfundimtare duhet të jetë e mbuluar me dheun, e cila është adekuate me dheun e mëparshëm dhe ku do ti përshtatet substratit te tokës.

Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara apo të degraduar nga ndryshimi i destinimit do të përfshij rivitalizimin në tërësi të hapësirës së dëmtuar nga veprimtaria ekzistuese. Zgjedhja e rikultivimit dmth modelit, varet edhe nga qëllimi i përdorimit të tokës, siç do të jetë e paraparë me planet komunale..

12. KONKLUZION

Me respektimin e masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, ndikimi i impiantit për prodhimin e betonit dhe elementeve te parafabrikuara nga betoni e cila do të jetë në nivel të vlerave dhe standardeve të caktuara me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Ndikimet e evidentuara janë të menaxhueshme dhe kontrollueshme. Këto ndikime do të monitorohen dhe do të raportohen në fund të cdo viti kalendarik, dhe sipas kërkesave të autoriteteve përkatëse.

Duke u bazuar ne të gjitha ato qe u thane me siper mendojme qe kompania FORTESA BETON SH.P.K. nga Prizreni i ploteson kushtet per tu pajisur me Pelqim Mjedisor per Impiantin e Prodhimit te beoni dhe elementeve te parafabrikuara nga betoni.

13. ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT NË FORMË TABELARE

Tabela 5. Tabela e kost-benefiteve të investimit

TABELA E KOST BENEFITIT TE INVESTIMIT NE IMPIANTIN E PRODHIMIT TË BETONIT DHE ELEMENTEVE NGA BETONI		
Nr.	Emri	Çmimi
1	Bunkerët	18,000.00
2	Traka e transportit te zhavorrit	7,000.00
3	Siloset 2 copë	12,000.00
4	Mikseri Komplet me Panel Komandues	18,000.00
5	Rezervari i ujit	1,000.00
6	Kompresori për furnizim me ajër	1,000.00
7	Tre automikseret e Betonit	30,000.00
8	Një auto-pomp betoni	35,000.00
9	Një lugë ngarkuese	41,000.00
10	Vibropresa	35,000.00
Gjithsej vlera investuese:		198,000.00

FORTESA BETON SH.P.K.

14. LITERATURA E PERDORUR

Lista e bibliografisë (referencave) së burimeve të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e përfshira në raport.

- Te dhënat nga Investitori,
- Projekti Konceptual,
- Harta zonale komuna Prizren
- Pzhk – Prizren,
- Kërko dhe paraqit - KGP (rks-gov.net)
- Google Maps
- FORTESA BETON / Ballina
- LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS (rks-gov.net)